



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1080 prot.

Elbasan, më 14.05.2021

**VENDIM**

Nr. 13 datë 14.05.2021

**“PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 7 DATË 14.04.2021  
“PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES DHE FORMËS SË DIPLOMAVE QË DO TË  
LËSHOHEN NGA UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**

Bazuar në Ligjin Nr. 80 /2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Udhëzimin Nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, të ndryshuar Kreu II pika 1, në Statutin e Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, neni 9, Senati Akademik më datë 14.05.2021

**V E N D O S I**

1. Në Vendimin e Senatit Akademik nr. 7, datë 14.04.2021 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së diplomave që lëshohen nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër. Xhuvani” për programet e studimit me karakter profesional në “Operator turistik në gjuhë gjermane” dhe “Teknik mjedisi” bëhen këto shtesa:
  - Shënohet emri i njësisë kryesore/fakultetit që ofron programin e studimit me shkronja të mëdha në qendër të formës poshtë emri të universitetit.
  - Në pjesën e poshtme të diplomës vendoset shënimi: “Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj.
2. Përmbajtja dhe forma e diplomës që do të lëshohen nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për programet e studimit me karakter profesional në “Operator turistik në gjuhë gjermane” dhe “Teknik mjedisi” do të jenë sipas modelit bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Rektori dhe Administratori për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof.dr. Skender TOPI**